



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVË	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPÇTINA VUŠTRIN	
01 Nr. / Br	274/15
Nr. i fq. / Br. sh	- 14 -
Data: / Ditim	30.12.2015
VUSHTRISË - VUŠTRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E IX-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRISË,**  
**MBAJTUR MË 30 NËNTOR 2015**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Adnan Klinaku, anëtar i kuvendit** –në fillim të mbledhjes dha betimin para anëtarëve të kuvendit, dhe me këtë rast u bë anëtari i kuvendit me të drejta të plota.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –paraqiti dy pika shtesë të rendit të ditës duke shtuar se këto materiale iu janë dërguar përmes adresës elektronike dhe të njëjtat propozoi që të futen në rend të ditës. Gjithashtu ai njoftoi kuvendin për një kërkesë të një qytetari, i cili ka kërkuar ndërrimin e destinimit të një parcele kadastrale në fshatin Druar dhe arsyetoi që kjo pikë duhet të futet në rend dite pasi ky qytetar ka fituar një donacion dhe kjo çështje është e afatizuar dhe urgjente.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** – paraqiti vërejtjet e saj për piken e 13 të rendit të ditës duke shtuar se ky propozim është gjysmak pasi i mungon lisat për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe se një vërejtje e tillë është dhënë edhe në KPF, andaj në emër të grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –lidhur me piken e 13 të rendit të ditës sqaroi se lista e emërtimeve dhe riemërtimeve është duke u hartuar se gjatë mbledhjes të ofrohet para kuvendit, dhe në të njëjtën kohë arsyetoi se kjo pikë e rendit të ditës është proceduar për kuvend për shkak të urgjencës së kësaj çështje pasi komuna ka lidhur një marrëveshje me Qeverinë Norvegjeze.

**Habib Mustafa, anëtarë i kuvendit**- propozoi që pika e 13 e rendit të ditës të mos hiqet nga rendi i ditës pasi Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Emërtimin e Rrugëve e ka kryer punën e tij me kohë, por arsyetoi se për shkak të volumit të madh të ankesave teknikisht nuk ka

pasur mundësi që hartohet lista definitive e emërtimeve të rrugëve. Pastaj ai njoftoi se konform ankesave të shqyrtuara del se nuk ka ndryshime të emrave të rrugëve e që i bie se prapë janë emrat ekzistues të atyre rrugëve por vetme ka emërtime të reja.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** –tha se përmes anëtares së tyre në komisionin në fjalë janë njoftuar se procesi i shqyrtimit të ankesave lidhur me emërtimin e rrugëve ka përfunduar dhe shtoi se nëse teknikisht kjo listë e rrugëve ofrohet para kuvendit propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të futet për shqyrtim.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit**-propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet por me kusht që materiali të ofrohet para anëtarëve të kuvendit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se materiali i cili ka të bëjë me Planin Lokal për Riintegrim nuk është dërguar në mënyrë të rregullt, për faktin se nuk dihet se nga kush është hartuar ky plan dhe për kënd është adresuar, andaj për këtë çështje kërkoj deklarinimin e kuvendit për heqjen e saj nga rendi i ditës.

**Ergyn Sunguri, anëtar i kuvendit** –pasi foli në cilësinë e anëtarit të komisionit të ankesave propozoi që pika e 13 të mos hiqet nga rendi i ditës pasi që procesi i shqyrtimit të këtyre ankesave ka përfunduar dhe tani vetme pritet lista përfundimtare.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-në prononcimin e tij lidhur me rendin e ditës arsyetoi se pika në që është dërguar në të ndryshme Draft-Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim duhet të procedohet për shqyrtim dhe i njëjti duhet të aprovohet pasi kjo çështje është e afatizuar dhe këtë e ka kërkuar Ministria e Integritimit Evropian që ky plan duhet të aprovohet deri në fund të muajit nëntor.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 28 vota "për" të tjerat "abstenim" aprovoi këtë:**

#### REND DITE

- 1.Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
  2. Shqyrtimi i informatës për gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë;
  - 3.Shqyrtimi i informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve;
  - 4.Shqyrtimi i informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit;
  - 5.Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
  - 6.Shqyrtimi i Raportit Vjetor i Komitetit Këshillëdhënës për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini;
  - 7.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01 nr.70/14 të datës 27.03.2014;
  - 8.Shqyrtimi i Draft-Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre;
  - 9.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës, tokë bujqësore dhe kullosa;
  - 10.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;
  - 11.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;
  - 12.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për aprovimin e listës për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
  - 13.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për transferimin dhe harmonizimin e mjeteve buxhetore të komunës në paga dhe mëditje.
  - 14.Shqyrtimi i Draft-Strategjisë Komunale për Integrimin e Komuniteteve jo shumicë.
  - 15.Të ndryshme.
- a).Shqyrtimi i Draft-Planit Lokal për Riintegrim.

- b).Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Verifikues për ndarjen e subvencioneve (lopëve qumështore).
- c).Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit lidhur për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së punës të kuvendit.
- ç). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

1.Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.*

2. Shqyrtimi i informatës për gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar informatës në fjalë tha se në informatë është cekur se duke pasur parasysh nevojat e pacienteve është shtuar numri i shërbimeve laboratorike edhe me 5 shërbime tjera: Kreatinina, AST, ALT Bilurubina totale dhe direkte, lidhur me këtë ceku se për këto analiza nuk janë shfaqur nevojat tani por këto nevoja kanë ekzistuar kaherë, dhe pyeti se përse këto analiza nuk janë kryer më herët. Pastaj ceku se kur flitet për numrin e pacienteve të cilëve iu janë ofruar shërbime laboratorike atëherë këtu del se shifra prej 11.505 pacientëve është gabim sepse kjo shifër duhet të jetë shumë më e lartë. Tutje ai inkurajoj përpjekjet për ofrimin e shërbimeve stomatologjike 24h dhe ofrimin e këtyre shërbimeve edhe në QMF në fshatra si dhe pyeti furnizime me dy karrige stomatologjike në dy fshatra në cilat fshatra do të bëhet. Kurse sa i përket shërbimeve radiologjike –RTG ku thuhet se janë ofruar shërbime për 3.503 pacientë që i bie se janë bërë kryer 3503 incizime kurse nuk është lexuar asnjë film dmth. nuk ka radiolog dhe pacientet “shëtitën” lart dhe posh duke mos mundur ti marrin këto shërbime. Në vazhdim ai vlerësoi se mungesa e radiologëve po ndikon shumë keq tek qytetarët në mungesën e shërbimeve në këtë drejtim apelo tek drejtoria komunale që të gjendet një zgjidhje. Pastaj shërbimet të paraqitura në formë tabelore ku në mjekësi familjare janë ofruar 156.256 shërbime në formë të vizitave, ndërsa nëse e mbledhim shifrën për të gjitha shërbimet e ofruar atëherë del se për këtë nëntë mujor kemi pasur gjithsejtë 389.604 shërbime të ofruara andaj kur llogarisim se në vitin 2011 Komuna e Vushtrrisë ka pasur rreth 80.000 banor atëherë i bie që brenda gjashtë muajve janë kontrolluar komplet popullata e komunës së paku nga pesë herë dhe kjo mund të thuhet se është një absurd. Mandej kur bëhet fjalë për sëmundjet infektive kemi sindromin i verdhëzës A ose hepatit i thjeshtë thuhet se në këtë nëntë mujor nuk pasur asnjë rast kurse njoftoi se në ordinancën e tij ka pasur tri raste, kurse hepatit B dhe C i cili është mjaft i përhapur në Vushtri dhe mund të thuhet se jemi ndër komunat ku më së shumti është e përhapur kjo sëmundje, në këtë kontekst ai shtoi se kemi shifra jo të sakta sa i përket përshkrimit në informatë të numrit të pacienteve që vuajnë nga sëmundje të ndryshme. Tutje kur bëhet fjalë për furnizim me barna dhe material shpenzues thuhet se furnizimi me material shpenzues ka qenë i mirë kurse në fund ka dal se furnizimi ka qenë 58.2%, ku kemi pasur variacion nëpër muaj. Në fund ai pyeti se sa është numri i mjekëve dhe i stafit ndihmës mjekësor në QKMF në Vushtri.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit**-pyeti se a është bërë ndonjë analizë se përse Komuna e Vushtrrisë ka aq shumë person që vuajnë nga sëmundja e hepatit B dhe C e cila është mjaft shqetësuese.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** –pasi përgëzoi drejtorin për hartimin e një informate gjithëpërfshirëse dhe shtoi se infrastruktura mund të thuhet se është rregulluar kurse numri i madh i pacientëve dhe shërbimeve shëndetësore del për faktin se akoma nuk kemi arritur të zbatojmë konceptin e mjekësisë familjare. Pastaj ceku se paraqitja e sëmundjeve infektive është mjaft evidente dhe kjo parqet shqetësim për ne të gjithë sidomos hepatit B dhe C që me të

vërtetë është një numër i madhe i të infektuarve dhe shi për këtë duhet që si sektori publik po ashtu edhe ai privat duhet të bëjnë paraqitjen e këtyre rasteve të pacientëve të sëmurë. Tutje vlerësoi se monitorimi dhe kontrolli i sektorit privat nuk është në kompetenca të komunës por të Inspektoratit Shëndetësor dhe sidomos dobësitë ndihen në ordinancat stomatologjike, ku ka intervenime kirurgjike dhe për këtë paraqiten shumë sëmundje infektive. Pastaj duke ju referuar informatës në fjalë ku janë përfshirë sëmundjet infektive gjatë këtij viti ku kemi pasur raste sidomos të sëmundjes së paritetit ku mund të thuhet se kjo epidemi ka qenë e përhapur nëpër shkollë në vende ku kemi frekuentim të njerëzve. Tutje shtoi se kur bëhet fjalë për shërbimet e rëntgenit është evidente se nuk kemi funksionim të mirë dhe kjo ka shkaktuar probleme edhe për qytetaret për incizime të ndryshme. Në fund tha se furnizimi me barna bëhet nga Ministria e Shëndetësisë por prapë se prapë mund të thuhet se furnizimi është i kënaqshëm.

**Abdullah Klinaku, drejtor i DSHMS-së**-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit** –duke ju referuar tabelës së paraqitur në informatë ku thuhet dyshime në tularëmi ceku se përse thuhet “*dyshimi*” kur dihet fakti se nuk ka pasur raste të vërtetat të infektimit me këtë sëmundje. Tutje pyeti se a kemi analiza për përhapjen e kësaj sëmundje në shkollën SHMU2, a ka pasur kontroll shëndetësor të nxënësve të kësaj shkolle dhe personelin arsimor si dhe cilat masa janë ndërmarr në përvetimin e kësaj sëmundje ku fati ishte se ishte fundi i vitit se sëmundja do ta përfshinte të gjithë shkollën.

**Abdullah Klinaku, drejtor i DSHMS-së**-tha se në fillim të vitit kalendarik ka pasur në fluks të madh të infektimit të nxënësve me sëmundjen e tularëmis. Pastaj njoftoi që tabelat e përshkruara në informatë janë të hartuara nga Instituti Rajonal të Shëndetit Publik dhe në këtë kontekst drejtorja komunale nuk e ka legjitimitetin e ndërhyrjes në këto tabela. Në fund ai tha se në kohën kur ka pasur fluks të pacienteve me tularëmi drejtorja ka formuar një grup në bashkëpunim me sektorin e shëndetit publik për identifikimin e shkaktarëve të kësaj sëmundje dhe menaxhimin dhe mundësitë e evitimit të saj.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** –tha se lidhur me shkaqet e shfaqjes së tularësis dhe parotitit duhet të priten analizat serologjike të këtyre sëmundjeve e cila verifikohet në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe të njëjtat analiza dërgohen në Klinikën Infektive. Tutja njoftoi se në shkollën SHMU2 nuk ka pasur klasë të cilat kanë qenë komplet të infektuara nga kjo sëmundje dhe ceku se edhe përkundë vaksinimit prapë se prapë kemi pasur shfaqje të kësaj sëmundje.

3. Shqyrtimi i informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve.

**Syzana Sylja, anëtare e kuvendit** –tha se në informatën në fjalë tek sektori i zhvillimit ekonomik kur flitet për regjistrimin e bizneseve për vitet 2003 -2015 shihet se në Komunën e Vushtrrisë janë të regjistruara 2470 biznese, kërkoi nga sektori i lartë cekur të japë informatë me shkrim se sa biznese janë aktive sa janë pasive dhe sa të shuara gjatë kësaj periudhe. Pastaj numri i të punësuarve në këto biznese është 3646, kurse sa është numri i të papunëve në komunë tonë, kurse të vetë punësuarve në saje të bizneseve individuale në komunë tonë janë 2049 punëtorë e që gjithsej të punësuar janë 5695. Andaj kërkoi nga Sektori i Zhvillimit Ekonomik informatë me shkrim sa punëtor janë të siguar dhe pronaret e kompanive a paguajnë trustin pensional pasi kompanitë sigurojnë vetëm anëtarët e familjes kurse punëtorët tjerë nuk sigurohen.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se inkurajojmë përpjekjen e drejtorisë në fjalë për ofrimin e kësaj informate mirëpo ai paraqiti disa konstatime gjegjësisht vërejtje substanciale siç tha ai. Tutje kjo informatë është konfuzë sepse nuk ofron shënime të sakta për periudhën e tanishme, së dyti paraqitja tabelore ku askush nuk mund të kuptojë se a po raportohet për shifrat dhe kodet e veprimtarive ekonomike për vitin 2003-2015 apo po raportohet për 12 vite ku, sipas

planit të punës së kuvendit është dashur që Drejtoria për Ekonomi të ofroj informatë për strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në përgjithësi në komunën tonë. Pastaj në këtë informatë nuk ofrohet saktësi se sa biznese janë aktive dhe sa janë shuar si dhe kishte me qenë mjaft me rëndësi që kjo informatë të përmbajë edhe kodet e veprimtarive gjegjësisht të kemi një krahasim me vitin paraprak se cilat kode të veprimtarive ekonomike kanë rritje gjegjësisht shtim të veprimtarisë në bazë të regjistrimit dhe cilat kanë pasur rënie përkatësisht mbyllje të veprimtarisë ekonomike. Pastaj vlerësoi se sikur ta kishim pasur një raport të tillë kuvendi por edhe ekzekutivi do të duhej të fokusohet tek bizneset të cilat janë detyruar të mbyllen do të duhej gjithashtu të analizohen shkaqet e shuarjes së këtyre bizneseve dhe eventualisht të krijohen lehtësira. Në vazhdim ai ceku se çdo informatë e ka peshën e vet kur shqyrtohet por kjo informatë vërtet duhet të jetë më e kompletuar dhe më profesionale dhe të prezantohet ashtu si duhet. Lidhur me pagesën e trustit pensional nga ana e kompanive private ceku se me përgjegjësi të plotë siguron se kompanitë në fjalë i kryej këto pagesa (kontribute), dhe ky fakt mund të vërtetohet nga Administrata Tatimore përndryshe këto subjekte afariste nuk mund të zhvillojnë aktiviteti e tyre ekonomik. Në fund ai kërkoi nga drejtoria në fjalë por edhe nga kryetari i komunës që kjo informatë të përpunohet dhe të saktësohet me të dhëna të sakta dhe si e tillë të ofrohet në seancën e ardhshme.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit**-tha se është për tu përshëndetur fakti që komuna ka mundësuar që bizneset të regjistrohen pa pagesë dhe duke iu shmangur procedurave burokratike. Kurse lidhur me zhvillimin e bizneseve është shumë mirë që pronaret e ndërmarrjeve të vogla kapitalin e tyre e kanë orientuar në rritjen e bizneseve duke krijuar mundësi të reja për punësim. Në fund tha se nëse kërkohet që kjo informatë të ripërpunohet atëherë kërkoi që kësaj ti bashkëngjitet edhe njoftim apo të dhëna për trajtimin e punëtorëve në biznese pastaj të dhëna për respektimin e orarit të punës paga e tyre dhe të drejta e tjera relevante.

**Rakbete Krasniqi, zyrtare në Drejtorin e Ekonomisë**- paraqiti sqarime për anëtarët e kuvendit.

#### 4. Shqyrtimi i informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit.

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit** –tha se në fshatin Pantinë kanali është i mbyllur për shkak të mbeturinave, dhe kështu kemi ndotje të madhe të ambientit dhe e keqja është se ky kanal gjendet afër shkollës dhe kjo paraqet rrezik për shfaqjen e ndonjë epidemie. Andaj për këtë problematik propozoi që të hapet kanali dhe të vendosen gypat.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-tha se në fshatin Pantinë është ndërtuar një kanalizim dhe atë me gypa të gjanë por si duket ky projekt nuk është punuar si duhet dhe në këtë rast duhet të intervenohet në rregullimin e këtij kanalizimi.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit**-kërkoi që në të ardhmen këto informata që ofrohen para kuvendit të konkretizohen dhe mos të sillen në formë kaq të përgjithësuar.

#### 5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit**-kërkoi që në planin e punës së Kuvendit për vitin 2016, të futet edhe një raport gjashtë mujore lidhur me zbatimin e vendimeve të kuvendit nga ana e drejtorive komunale.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-tha se për çdo çështje të ngritur në kuvend kryetari i komunës por edhe drejtoret e drejtorive japin përgjigje qoftë verbale apo me shkrim. Pastaj kryetari i komunës në baza tre mujore dhe gjashtë mujore ofron raporte dhe informata për gjendjen e komunës në përgjithësi dhe ndër tjera informon në këtë formë edhe për zbatimin e vendimeve të kuvendit. Por në fund shtoi se nëse kuvendi e sheh të arsyeshme mund të bëjë një statistikë lidhur me zbatimin e këtyre vendimeve.

**Abit Abiti, ZKF**-paraqiti disa propozime lidhur me planin e punës së kuvendit për vitin 2016. **Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se e mbështet idenë që të futet në plani e punës së kuvendit raporti gjashtë mujor lidhur me zbatimin e vendimeve të kuvendit, dhe shtoi se në tani e tutje konform dispozitave ligjore vendimit të cilat i aprovon kuvendi të kenë edhe koston financiare dhe afatin e zbatimit (d.m.th afatin e përmbushjes) sepse deri me tani kuvendi ka aprovuar vendime paushallë dhe për zbatimin e atyre ne nuk kemi qenë në dijeni. Tutje arsyetoi se ligji obligon që çdo vendimi duhet ta ketë koston financiare të përlllogaritur dhe afatin e zbatimit të tij. Pastaj lidhur me draft-planin e kuvendit ceku se ky dokument është dokument i obligueshëm për kuvendi por edhe për ekzekutivin në realizimin punëve dhe aktiviteteve. Mandej ai duke ju referuar raportimit financiar para kuvendit ceku se askush nuk është kundër që të kemi raport gjashtë mujor për të hyrat dhe shpenzime, por insistoi që raporti edhe në baza tre mujore me qëllim të aplikimit të metodës së krahasimit.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –konstatoi dhe kërkoi votimin e planit të punës së kuvendit në formën e draft të propozuar duke ja bashkangjitur edhe propozimet bëra nga anëtarët e kuvendit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 29 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

*Aprovohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2016.*

6.Shqyrtimi i Raportit Vjetor i Komitetit Këshillëdhënës për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** –tha se në këtë raport kemi vetëm disa rekomandime të cilat ky komitet i ka bërë për vitin e kaluar në fushën e sportit dhe të rinisë kurse për fushat tjera nuk ka asnjë sugjerim ose propozim eventual.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** –tha se ky raport më tepër i ngjan një plani të punës ku fletë për numrin e mbledhjeve dhe gjana tjera të cilat nuk ka qenë e nevojshme të përfshihen në këtë raport. Andaj ai propozoi që të ndërrohet qasja e raportimit qoftë e drejtorive qoftë e komiteteve këshillëdhënëse.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** –falënderoi kryesuesin e Komitetit Këshillëdhënës për Arsim dhe inkurajoi që të punoj edhe më shumë në të ardhmen.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit**-tha se kur flitet për rolin e këtij komitetit ku thuhet se “komitetit ka për detyrë ti paraqes rekomandimet dhe mendimet e qytetarëve tek kryetari i komunës” tha se një artikulum i tillë është i gabueshëm pasi ky komiteti duhet të jetë profesional i cili profesionalisht do ti jepte rekomandimet e tij për çështje konkrete nga fusha përkatëse. Tutje vlerësoi që komitetet konsultative duhet të bashkëpunojnë me drejtorit përkatëse të linjës sidomos në hartimin e rregulloreve. Ndërsa shtoi se këtij raporti i mungojnë rekomandimet në sferën e arsimit, kulturës dhe fesë. Në fund ceku se nuk pajtohet që komitet e tilla konsultative të marrin rolin e një organi hetuesie.

7.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01 nr.70/14 të datës 27.03.2014.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha se lidhur me çështjen në fjalë ka punuar komisioni i formuar nga kuvendi, dhe ceku se me këtë rast është bërë një punë e mirë në përcaktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Stroc. Në fund ai propozoi që rruga deri tek lokacioni i varrezave të shtrohet si rrugë e rendit të katërt.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se e përkrah në tersi punën e komisionit në fjalë i cili ka gjetur një ujdi mes banorëve të këtyre lokaliteteve, dhe shtoi se kjo problematik është

shkaktuar pikërisht për shkak të neglizhencës së disa zyrtarëve komunal të cilët nuk i kanë kryer detyrat me kohë. Në fund tha se kjo çështje duhet të përfundoj sa më parë që të jetë e mundur dhe propozoi që rruga deri tek lokacioni i varrezave të shtrohet si rrugë e rendit të katërt.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendimi plotësohet dhe ndryshohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr.70/14 i datës 27.03.2014, për caktimin e lokacionit për varrezat në fshatin Stroc, në atë mënyrë që lokacioni i mëparshëm ndërrohet për rreth 200m në drejtim të pjesës perëndimore të njëjtës parcelë nga vendi i mëparshëm.

2. Komuna e Vushtrrisë merr për obligim që të bëjë ndërtimin e rrugës nga rruga kryesore deri tek lokacioni i varrezave si rrugë e rendit të katërt.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

8.Shqyrtimi i Draft-Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukuritë që Dëmtojnë Shëndetin dhe Zhvillimin e Tyre.

2.Diskutimi publik fillon nga data 03 dhjetor 2015 dhe zgjatë deri më 21 dhjetor 2015.

3.Obligohet Zyra Komonale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHPS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin nëntor 2015.

9.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënie në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës, tokë bujqësore dhe kullosa.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** –tha se në saje të këtij propozim vendimi ne si kuvend po japi në shfrytëzim rreth 70 hektar tokë për të cilën gjë nuk është kundër për faktin se këto prona duhet të jepen në shfrytëzim me qëllim të zhvillimit të bujqësi që bujqit tanë të përfitojnë por edhe komuna në të njëjtën kohë. Tutje vlerësoi se kuvendi edhe më herët ka dhënë prona në shfrytëzim por se profit i komunës nga kjo fushë është zero për shkak të mos inksimit që qirasë. Mandej ai kërkoi që për pronat të cilat jepen në shfrytëzim të respektohen kriteret dhe mos tu jepen pronat atyre të cilët kanë uzurpuar. Në fund apeloi që dokumentet të cilat vinë nga KPF-ja në kuvend të lekturohen dhe të hiqet teksti që thuhet se Komitetit për Politikë dhe Financa merr vendim për dhënie në shfrytëzim kur dihet se kuvendi është ai i cili i merr vendimit.

**Isa Hajrizi, anëtari i kuvendit**-duke ju referuar një vendimi të mëhershëm të kuvendit për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore është përcaktuar që çmimi fillestar për hektarë është

përcaktuar të jetë 50€. Pastaj njoftoi që në po atë vendim është marrë obligimi që për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të kenë të drejtën e konkurrimit personat fizik në vlerën deri 2 hektar dhe personat juridik kurse për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë të marrin pjesë vetëm personat juridik.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –tha se për të gjitha këto prona të cilat kuvendi po i jep në shfrytëzim komuna sikur po dështon në inkasimin e të hyrave nga këto prona andaj kërkoi që të silltet një listë e personave përfitues të këtyre pronave, dhe të bëhet krahasimi me këtë vit se kush do të përfitoj, për faktin se disa përfitues po tolerohen dhe nuk po paguajnë komunës mjetet e qirasë për të cilën janë dhënë këto prona.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** –tha se kur bëhet fjalë për dhënien e pronës në shfrytëzim duhet pasur shumë kujdes për faktin se në shumë aspektet me këto vendime vetëm sa po bëhet legalizimi i atyre pronarëve që janë uzurpues të pronës komunale. Tutje shtoi se është mirë që ky propozim të korrigjohet edhe nga ana teknike dhe të harmonizohet edhe rregulloret tjera të cilat i ka aprovuar kuvendi dhe në këtë formë të jepet në shfrytëzim.

**Bedri Dobra, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër**-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke dhënë sqarime për anën teknike të parcelave të dhëna në propozim-vendim e të cilat do të jepen në shfrytëzim.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-tha se jemi duke bërë përpjekje që pronën komunale ta identifikojmë dhe të njëjtën ta japim në shfrytëzim me qëllim të rritjes së të hyrave komunale. Pastaj ceku se çështja e pronës është mjaft e ndjeshme për faktin se kemi mjaft uzurpime dhe ndërtime tjera në pronë publike andaj dhënia në shfrytëzim e këtyre prona mund ti prek edhe interesat e këtyre grupeve. Tutje ai vlerësoi se tani është duke u bërë një punë e mirë pasi kemi filluar me dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave dhe menaxhimin e tyre me qëllim që këto prona mos të “mbesin në duart” e uzurpatorëve. Mandej lidhur me vlerësimin se nuk fare të hyra nga dhënia e pronës në shfrytëzim njoftoi se të hyra ka relativisht mirë dhe për këtë çështje do ti informoheni saktë në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit. Kurse për të gjithë ata fermer të cilët nuk i kanë paguar qiranë komunës lidhur me shfrytëzimin e pronave komunale janë iniciuar procedurat ligjore për ngritjen e padive në gjykatë.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha se nuk është qëllimi i kuvendit që të prolongoj këtë pikë të rendit të ditës pasi ne si kuvend është për ti ndihmuar këta fermer, por komisioni i formuar për këtë çështje duhet të bazohet ekskluzivisht në këtë vendim dhe ky vendim duhet të jetë i qartë.

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së**-paraqiti sqarime lidhur me menaxhimin e pronës komunale, duke njoftuar se ka rritej të hyrave komunale nga dhënia e pronës në shfrytëzim qoftë ajo bujqësore apo ndërtimore.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit**-tha se për shkak të bujqve është mirë që kjo pika e rendit të ditës të votohet sot të shpallen procedurat e ankandit publik dhe mos të vonohemi në dhënie e kësaj prone në shfrytëzime, dhe mbeti pas propozimit që për 1 ha çmimi fillestar të jetë 50€.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se të gjithë jemi që kjo pronë të jepet në shfrytëzim, por vlerësoi se nëse veprojmë kështoj mund të ndodh që komuna të jetë e paditur nga ndonjëri prej përfitueseve duke marrë për bazë se ky vendim nuk është i qartë dhe nuk e precizon saktë sipërfaqen e tokës e cila jepet në shfrytëzim. Andaj si zgjidhje në këtë moment kërkoi që deklarohet zyra ligjore lidhur me këtë çështje.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit**-tha se duhet të identifikohen dhe të lirohen nga uzurpimi pronat komunale dhe pastaj të jepen në shfrytëzim konform kritereve ligjore.

**Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor**-paraqiti sqarime ligjore lidhur me propozim-vendimin në fjalë duke sqaruar anën faktike dhe juridike të çështjes në fjalë.

**Bedri Dobra, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër**-paraqiti sqarime shitesë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke shtuar se kemi një jo përputhje mes gjendje faktike dhe certifikatave pronësore dhe njoftoi se do të bëhen korrigjimet e përshtatshme me qëllim të

përcaktimit të saktë të sipërfaqes e cila do të jepet në shfrytëzim. Në vazhdim ai dha sqarime të specifikuara lidhur me sipërfaqen e dhënë në shfrytëzim.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –tha se kjo pikë e rendit të ditës nuk është e hartuar si duhet dhe e njëjta nuk e ka marr mendimin e zyrës ligjore andaj propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-tha se edhe gjatë zhvillimit të procedurave të ankandit komisioni mundet të evidentoi ndonjë defekt andaj ai do ta ketë mundësin që me këtë rast ti bëjë përmirësimet e nevojshme.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –në saje të sqarimeve lidhur me sipërfaqen e tokës e cila jepet në shfrytëzim konstatoi me sa vijon: nga parcela kadastrale me nr.P-70202011-00435-1 me sipërfaqe prej 13.01.76 ha, jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 07.05.00ha, zona kadastrale Lummadh pronë e Komunës së Vushtrrisë, nga parcela kadastrale P-70202011-00435-3 me sipërfaqe prej 06.08.10 ha jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 06.02.64 ha zona kadastrale Lummadh pronë e Komunës së Vushtrrisë, nga parcela kadastrale me nr.P-70202022-00512-1 me sipërfaqe prej 05.36.93 ha, jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 04.30.00 ha Zona Kadastrale Gracë pronë e Komunës së Vushtrrisë, nga parcela kadastrale me nr.P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 03.52.86 ha jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 03.24.00 ha Zona Kadastrale Stanoc i Poshtëm pronë e Komunës së Vushtrrisë, nga parcela kadastrale me nr.P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 00.70.00 ha jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 00.62.00 ha Zona Kadastrale Stanoc i Poshtëm pronë e Komunës së Vushtrrisë, si dhe bëhet korigjimi i numrit të parcelës kadastrale nga P-70202002-00051 të bëhet P-70202002-00492 me sipërfaqe prej 11.97.88 ha Zona Kadastrale Balincë pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës tokë-bujqësore dhe kullosa në këto ngastra kadastrale:**

**1.1 Ngastra Kadastrale me nr.P-702020011-00435-1, me sipërfaqe prej 07.05.00 ha, Zona kadastrale Lummadh, pronë e Komunës se Vushtrrisë.**

**1.2 Ngastra Kadastrale me nr. P-70202011-00435-3, me sipërfaqe prej 06.02.00 ha Zona kadastrale Lummadh pronë e Komunës se Vushtrrisë.**

**1.3 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00271-0, me sipërfaqe prej 01.03.64 ha, Zona Kadastrale Gracë, pronë e komunës së Vushtrrisë.**

**1.4 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00209-0, me sipërfaqe prej 23.45.12 ha, Zona Kadastrale Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

**1.5 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202022-00512-1, me sipërfaqe prej 04.30.00 ha, Zona Kadastrale Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

**1.6 Ngastra Kadastrale me nr.P-70202028-00412-1, me sipërfaqe prej 03.24.00 ha, Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

**1.7 Ngastra Katastrale me nr.P-70202028-00412-4, me sipërfaqe prej 00.62.00 ha, Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

**1.8 Ngastra Katastrale me nr. P-70202002-00492, me sipërfaqe prej 11.97.88 ha, Zona Katastrale Balincë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

2.Ngastrat kadastrale të cekura në piken 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatshkurtër me veprimtari kryesisht për kultura lavërtari, çmimi fillestar do të jetë 100€ për 1 ha në vit në afat prej 3 viteve me mundësi vazhdimi edhe për 3 vite tjera.

3.Obligohet Komisioni për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimit të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

10.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së**-paraqiti sqarime hyrëse, duke shtuar se ky propozim-vendim i është nënshtruar zyrës ligjore dhe për këtë çështje ne e kemi opinionin ligjor, por ishte i mendimit se kjo ishte një sipërfaqe nga parcela e përgjithshme dhe nuk kemi një specifikim të sipërfaqes e cila po jepet në shfrytëzim apo më konkretisht nuk dihet saktë sa metra katror i merren secilës parcelë andaj propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga diskutimi dhe të prolongohet për ndonjëherë nga seancat e ardhshme të kuvendit.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha se shumica e këtyre pronave janë duke u shfrytëzuar nga persona të caktuar të cilët i kanë paguar komunës taksat dhe obligimet tjera, andaj i sugjeron drejtorisë që këtë kujdes kur i shpall procedurat për konkurrent apo përfitues të ri eventual. Andaj nga të sipër cekurat propozoi që këto prona të mos dalin në ankand pasi që shfrytëzuesit janë duke i shfrytëzuar këto prona me kontratë dhe konform ligjit për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe se këta persona janë pagues të rregullt të taksave.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-tha se nuk është në interes të komunës që tani ti shpall këto procedura por, për këtë çështje ka pasur vërejtje nga auditori i përgjithshëm pasi shfrytëzuesëve aktual iu ka skaduar kontrata e që me hyrjen në fuqi të ligjit të ri këtyre shfrytëzuesëve aktual nuk mund tu vazhdohet kontrata pa ju nënshtruar konkurrencës. Andaj ju sugjeroi anëtarëve të kuvendi që këtë pikë të rendit të ditës ta prolongojnë për seancën e ardhshme.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

*Hiqet nga rendi i ditës Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, me rekomandimin që të bëhen analizat e duhura juridike në zyrën ligjore të komunës.*

11.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-paraqiti sqarime hyrëse, duke shtuar se bëhet fjalë për dislokimin e një trafostacioni të KEDSI-it i cili gjendet afër objektit të ri të komunës prapa “hamamit të qytetit” e cila gjendet në pozitë të keqe, kurse i njëjti stabiliment do të vendosët afër objektit të “Viva freshit”.

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së**-tha se ky propozim-vendim ka marrë mendimin e zyrës ligjore dhe është në pajtueshmëri me ligjin për dhënien në shfrytëzim.

**Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor**-lexoi nenin 10 paragrafi 1.5 të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe konstatoi se konform këtyre dispozitave operatori i KEDSI-it nuk i nënshtrohet procedurave të konkurrimit ku kemi mi të bëjmë me rast të veçanta të dhënës së pronës në shfrytëzim.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” 1 votë “kundër” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet dhënia ne shfrytëzim afatgjate për 99 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-06006-0, Zona Kadastrale Vushtrri e cila përfshin një sipërfaqe prej 30m<sup>2</sup> të marre nga sipërfaqja e përgjithshme 4807m<sup>2</sup>.

2.Ngastra kadastrale e cekur në piken 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim afatgjate për 99 vite KEDS-it për vendosjen e trafostacionit ne sipërfaqe prej 30m<sup>2</sup> pa kompensim.

3.Me zbatimin e planeve rregulluese urbane nga komuna obligohen: institucioni, kompania kompetente qe ta beje dislokimin e trafostacionit energjetik me mjete të saj përcjellëse ashtu siç kërkohet nga organi kompetent.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Prone dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

12.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për aprovimin e listës për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-tha se kjo listë e emërtimit të rrugëve ka pësuar ndryshime pas ankesave të parashtruara nga ana e qytetarëve, andaj vlerësoi se edhe nëse për këtë mbledhje nuk mund të ofrohet në mbledhjen e ardhshme te kuvendit gjithësesi duhet ofrohet para anëtarve të kuvendi dhe propozoi që kjo listë të publikohet edhe faqen zyrtare të komunës me qëllim që kjo listë të jetë transparente.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** –tha se pasi komision konstatoi se nuk ka ndryshime në emërtimin e rrugëve, dhe shtoi se pasi bëhet fjalë për interes të komunës (fitimin e një donacioni) atëher është mirë qe ky propozim të votohet.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –tha se lista për emërtimin e ka pasur kohë një muaj të hartohet, por pasi nuk është hartuar së paku sot ne këtë mbledhje të kuvendit është dashtë të ofrohet por pasi kjo listë nuk ka ardhur atëherë propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** –tha se komuna jonë ka punuar për së mbari në hartimin dhe emërtimin e rrugëve të komunës dhe mund të thuhet se ky proces ka shkuar mirë, mirëpo kjo listë me këto ndryshime sot në këtë mbledhje është dashur të ofrohet dhe e njëjta të votohet. Tutje shtoi se në piken 2 të këtij propozim-vendimi thueht që pjesë e këtij vendimi është lista e emërtimit dhe riemërtimit të rrugëve dhe riemërtimi nënkupton ndrrimin e emraave andaj në këtë formë nuk kemi njohuri se për qfarë ndryshimesh jemi duke votuar. Prandaj propozoi që ky vendim të aprovohet me kusht që në mblldhjen vijuese të silllet kjo listë me të gjitha ndryshimet eventuale.

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së**-paraqiti sqarime lidhur me këtë çështje, duke shtuar se procesi i shqyrtimit të ankesave ka marrë shumë kohë pasi ka pasur një volum të madh të anëkesave dhe për secilen anëkes është bërë procesi dhe është dashur të dilet edhe në teren andaj kjo listë teknikisht ka marr shumë kohë dhe e njëjta nuk ka mundur të ofrohet para anëtarëve të kuvendit. Në fund propozoi që kjo pikë të shtyhet për seancën vijuese.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** –tha se janë informuar nga përfaqësuesja e tyre në komision për emërtimin e rrugëve dhe shtoi se pasi bëhet fjalë për një çështje me rëndësi atëherë grupi i tyre kuvendar do ta votoi këtë pikë, me kushtin se humbet donacioni por në të kundërtën mirë është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** –sqaroi se është kundër që të humbet donacioni dhe shtoi se për mos hartimin me kohë të kësaj liste nuk është përgjegjës komisioni dhe as anëtarët e kuvendit, në këtë kontekst propozoi që ky vendim të votohet në parim.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –propozoi që anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin dhe rrimërtimin e rrugëve të kompensohen.

**Ergyn Sunguri, anëtar i kuvendit** –në cilësinë e anëtarit të komisionit njoftoi se komisioni ka punuar shumë edhe me qytetar dhe ka bërë një punë të mirë andaj, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të mos shtyhet.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –tha se komisioni për emërimin dhe rrimërimin e rrugëve duhet të kompensohet pasi ka bërë një punë të madhe, dhe apeloj që herëve tjera materiali për pikat e rendit të ditës të ofrohet me kohë.

**Abit Abiti, ZKF**-tha se propozimi për kompensimin e komisionit të rrugëve duhet analizohet nga zyra ligjore e komunës.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se është mirë që komisioni në fjalë të kompensohet, dhe njoftoi se ndryshime sa i përket emrave të rrugëve nuk ka pasur.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** –tha se pas konsultimeve që kanë pasur grupi kuvendar i LDK-së mendon që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj, me kusht që në mbledhjen e ardhshme të kuvendit të ofrohet lista përfundimtare e emërimit dhe rrimërimin e rrugëve.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –në fund të debatit konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës aprovohet me kusht që mbledhjen e ardhshme të dërgohet lista për emërimin dhe rrimërimin e rrugëve si dhe me propozimin që anëtarët e komisionit të kompensohen me nga 200€ për secilin anëtar të komisionit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim aprovohet lista për emërtimin dhe rrimërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista me emërtime dhe rrimërtime të rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Drejtorja për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

1.Me këtë vendim lejohet kompensimi i anëtarëve të Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave lidhur me Emërtimin e Rrugëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2.Vlera e kompensimit për secilin anëtar të këtij komisionit do të jetë 200€.

3.Obligohen anëtarët e komisionit në fjalë të sjellin dëshmi për pjesëmarrjen në mbledhjet e këtij komisioni.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

13.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për transferimin dhe harmonizimin e mjeteve buxhetore të komunës në paga dhe mëditje.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë Vendim bëhet transferi dhe harmonizimi i mjeteve buxhetore të komunës nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si në vijim: administrata kodi 1634 në shumën prej 3,052.00€, çështjet gjinore kodi 16524 në shumën prej 1,030.00€, bujqësi, pylltaria dhe zhvillimi rural kodi 47024 në shumën prej 2,244.00€ gjithsejtë 6,326.00€.

2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij vendimi transferohen dhe harmonizohen në kategorinë e pagave dhe mëditjeve zyra e kryetarit kodit 16024. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe fletë transferi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe i njëjti i dërgohet Ministrisë së Financave.

14. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë Komunale për Integrimin e Komuniteteve jo shumicë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota "për" të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendimi aprovohet Strategjia Komunale për Integrimin e Komuniteteve Joshumicë 2016-2020 në Komunën e Vushtrrisë.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin "Strategjia Komunale për Integrimin e Komuniteteve Joshumicë 2016 - 2020".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Zyra për Komunitete dhe drejtorit tjera kompetente.

15. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Draft-Planit Lokal për Riintegrim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota "për" të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Lokal i Veprimit për Riintegrimin e Komunitetëve të Vushtrrisë.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin "Plani i Lokal i Veprimit për Riintegrimin".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra për Komunitetet dhe Kthim, Zyra për Integrimin Evropian, si dhe drejtorit tjera kompetente.

b). Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Verifikues për ndarjen e subvencioneve (lopëve qumështore).

c). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit lidhur për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së punës të kuvendit.

*Kuvendi me vota unanime aprovoi qelsin prej 5 anëtarëve për formimin e komisionit lidhur për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së punës të kuvendit.*

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi Fatime Hazirin për anëtare të komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së punës të kuvendit.

**Isa Hajrizi, anëtari i kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi Qerim Selimin dhe Muharrem Shabanin për anëtar të komisionit në fjalë.

**Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Mehmet Selacin për anëtar të komisionit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota "për" të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim formohet komisioni komunal për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij në këtë përbërje:

1.1 Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit (PDK)

1.2 Qerim Selimi, anëtar i kuvendit (PDK);

1.3 Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit (PDK);

1.4 Fatime Haziri, anëtare e kuvendit (LDK); dhe

1.5 Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit (LVV);

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

ç). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-kërko**i mendimin e zyrës ligjore lidhur me propozim-vendimin në fjalë pasi tha se kjo çështje nuk ka kaluar nëpër procedurat e rregullta ligjore.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha se kërkesa në fjalë është parashtruar me vonesë dhe pasi bëhet fjalë për fitimin e një donacioni propozoi që ky propozim-vendim të aprovohet.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se të gjithë këtu jemi për respektimin e procedurave, por në rastin konkret kërko i sqarime nga drejtoria kompetente dhe propozoi që një kërkesë e tillë të aprovohet pasi bëhet fjalë për fitimin e një donacioni.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon

1.Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale P-70202030-00571-0 e cila është e evidentuar në certifikatën e pronësisë me nr.protok.18-6329/15 me sipërfaqe prej 7276m<sup>2</sup> me kulturë arë e klasës 5 (pesë) Zona Kadastrale Druar me pronar Sadullah Ali Salihu nga fsh.Druar.

2.Në parcelën kadastrale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi lejohet ndërtimi i objektit sipas projektit të prezantuar, për ndërtimin e shtallës.

3.Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 pika “b” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006 përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

4.Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore do ta lëshoj lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij vendimi konform dispozitave ligjore.

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6.Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa e parashtruar nga pala si dhe përshkrimi i projektit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova  
Kryesues i Kuvendit

